



Organizata për Demokraci Antikorrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!,

Input për Raportin e Progresit 2014

PROGRESI NË LUFTË KUNDËR KORRUPCIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Autorë: Lorik Bajrami dhe Arton Demhasaj

Inicuar dhe mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur në kuadër
të projektit

“Shoqëria Civile për Raport të Progresit 2014”



Qershor 2014

Prishtinë, Kosovë

Copyright © Organizata për Demokraci Antikorrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!, 2014

Ky studim u hartua nga [Organizata për Demokraci Antikorrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!](#), me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e [Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur \(KFOS\)](#).

Për më shumë informata:

www.cohu.org

www.kfos.org

Parathënie

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur mbështet proceset e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian që nga viti 2006, kur themeloi programin për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë. Që nga atëherë Fondacioni ka mbështetur vazhdimisht angazhimin e organizatave jo-qeveritare në këtë proces me analiza, monitorim të zhvillimeve në politika sektoriale, diskutime publike, dhe procese avokuese. Kjo mbështetje ka rezultuar me analiza të ndryshme gjatë viteve, dhe njëkohësisht me nxënie të njohurive thelbësore për proceset nga OJQ-të tona. Prandaj, duke bashkëpunuar me organizatat me të cilat tashmë është ndërtuar raport partneriteti, Fondacioni inicioi projektin “Shoqëria Civile për Raport të Progresit 2014” me të cilin ofroi një mundësi të veçantë për këto organizata të japin kontributin e tyre në për raportin e progresit 2014 dhe Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit.

Secila analizë e prodhuar në kuadër të kësaj mbështetjeje adreson një segment të veçantë të dialogut aktual mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duke prezantuar gjendjen aktuale, nga këndvështrimi i shoqërisë civile, të përcjellë me rekomandime të nevojshme për përmirësim të performancës.

Në shpresojmë se ky ushtrim do t'i ndihmojë jo vetëm organizatave tona jo-qeveritare për artikulum të mëtutjeshëm të zërit të tyre për proceset integruese, por po ashtu edhe Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndërtuar raport të qëndrueshëm bashkëpunimi me këtë segment të procesit shtet-ndërtues. Përfundimisht, shpresojmë se rezultat i angazhimit të të gjithë këtyre akterëve do të jetë përshpejtimi i proceseve integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe tejkalim i barrierave politike të cilat na qëndrojnë para në këtë rrugëtim.

Iliriana Kaçaniku

Programi për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë

Përmbajtja

HYRJE	5
I. Seksioni 2. Kriteret politike; 2.1 Demokraci dhe sundim i ligjit – lufta kundër korrupsionit	6
a) Ligji Për Deklarimin, Prejardhjen Dhe Kontrollin E Pasurisë Të Zyrtarëve Të Lartë Publik Dhe Deklarimin, Prejardhjen Dhe Kontrollin E Dhuratave Për Të Gjithë Personat Zyrtarë (Nr.04/L-050) (Nga Këtu, Ligji Për Deklarim Të Pasurisë)	6
Gjendja:.....	6
Sfidat:	7
Rekomandimet:.....	8
b) Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të publik (nr. 04/L-051) (nga këtu, ligji për parandalimin e konfliktit të interesit).....	9
Gjendja:.....	9
Sfidat:	9
Rekomandime:	12
II. Seksioni 4.3. Drejtësia, liria dhe siguria; 4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	13
Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale (nr. 04/L-140) (nga këtu: ligji për konfiskim të pasurisë).....	13
Gjendja:.....	13
Sfidat:	15
Rekomandime:	16

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të kontributit me shkrim të Organizatës për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!, për Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën për vitin 2014, i cili përfshin kontribut për kapitullin:

2.1 Demokraci dhe sundimi i ligjit – lufta kundër korrupsionit/lufta kundër krimit të organizuar (konflikti i interesit dhe deklarimi i pasurisë);

4.3 Drejtësia, liria dhe siguria – Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit (konfiskimi i pasurisë).

Kontributi i ÇOHU!, mbulon vetëm zhvillimet për periudhën e raportimit, duke filluar nga muaji tetor 2013 deri në fund të muajit qershor 2014.

HYRJE

Legjislacioni anti-korrupsion dhe anti-krim është përmirësuar në aspekte të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Megjithatë, paqartësitë, zbrazëtitat, por edhe sfidat për sa i përket objektivave të synuara në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe të krimit mbetin ende dhe këto kërkojnë një adresim të shpejtë dhe gjithëpërfshirës. Që nga viti 2013, disa amendamente janë përfshirë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), përkitazi me disa aspekte të legjislacionit anti-korrupsion dhe anti-krim. Në disa aspekte, këto ndryshime në KPRK, kanë sjellë përmirësime në parandalimin e korrupsionit, siç është rasti me rënien drastike të zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë, për shkak të penalizimit të këtij veprimi.

Prapëseprapë, çështjet të cilat ndërlidhen me mandatin dhe kapacitetet e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), për sa i përket hetimit të origjinës së pasurisë, si dhe mundësive për verifikim gjithëpërfshirës të informatave të ofruara në regjistrin e pasurisë (pasurisë së deklaruar), por edhe përmirësime brenda sferës së konfliktit të interesit, si dhe të konfiskimit të pasurisë, kërkojnë përmirësime imediate nëse kërkohen rezultate konkrete dhe cilësore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Në përgjithësi, tri trajta specifike e kanë përcjellë procesin e përgjithshëm të krijimit të infrastrukturës ligjore dhe institucionale anti-korrupsion.¹ E para, procesi i amendamentimit të ligjeve kundër korrupsionit, që nga zanafilla e tij më 2004, dhe deri në iniciativat e fundit më 2014, është bërë pa një analizë paraprake gjithëpërfshirëse të kornizës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit. E dyta, procesi i përgjithshëm i ndërtimit të kornizës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit, asnjëherë nuk është shqyrtuar në paketë, përveç në vitin 2010. E treta, si pasojë e të metave të lartpërmendura në qasje dhe metodologji, disa nene në ligjet kundër korrupsionit kanë konflikt me Kodin e Procedurës Penale (KPP), por edhe u mungon sistematizimi\harmonizimi, si dhe qartësimi me të.²

¹Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!; “Analizë Politikash – Korniza Ligjore kundër Korrupsionit; Mangësitë dhe Nevoja e Rishikimit”; faqe 2-3. Dhjetor 2011.

http://www.cohu.org/repository/docs/Anti-corruption_Legal_Framework-Shqip_588175.pdf

² ibid

Mirëpo, një karakteristikë e rëndësishme, si mungesa e vullnetit politik si dhe e angazhimit të vërtetë të spektrit politik vendor e ndërthurur me mungesën e kapaciteteve profesionale të institucioneve, e kanë shquar gjithë procesin e ndërtimit të institucioneve dhe aprovimin e ligjeve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.³

I. Seksioni 2. Kriteret politike; 2.1 Demokraci dhe sundim i ligjit – lufta kundër korrupsionit

a) Ligji Për Deklarimin, Prejardhjen Dhe Kontrollin E Pasurisë Të Zyrtarëve Të Lartë Publik Dhe Deklarimin, Prejardhjen Dhe Kontrollin E Dhuratave Për Të Gjithë Personat Zyrtarë (Nr.04/L- 050) (Nga Këtu, Ligji Për Deklarim Të Pasurisë)

Gjendja:

Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e lartë publik për herë të parë është futur si obligim më 2010. Që nga janari 2013, 'dështimi për të raportuar apo raportimi fals i pasurisë', sipas KPRK-së, konsiderohet vepër penale. Vendimi për të paralizuar 'refuzimin për deklaram', si dhe 'deklarimin e rrejshëm' të pasurisë në përgjithësi, është njëri ndër përparimet më esenciale në legjislacionin kundër korrupsion.

Si rezultat direkt i penalizmit të 'refuzimit për të deklaruar' pasuritë, nga zyrtarët e lartë publik, numri i atyre që dështojnë për të përmbushur këtë obligim ligjor ka rënë dukshëm. Më 2012, kur refuzimi për të deklaruar pasurinë nga zyrtarët të lartë publik nuk ka qenë vepër penale, numri i atyre që nuk e kishin deklaruar pasurinë ishte 216, përderisa më 2013 dhe 2014, numri ka rënë substancialisht në 35, përkatësisht në 2 zyrtarë që refuzuan ta deklarojnë pasurinë.

Kërkesat që dalin nga konkluzionet e 28-30 janarit, nga Dialogu i Procesit të Stabilizim dhe Asociimit (DPSA), për sa i përket aprovimit të amendamenteve në Ligjin për Deklarim të Pasurisë, me qëllim të

³ Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe Organizata ÇOHU!; Kultura e Mosndëshkueshmërisë në Kosovë; faqe 27. <http://kfos.org/ëp-content/uploads/2014/04/Kultura-e-mosnd%C3%ABshkushm%C3%ABris%C3%AB-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-ALB.pdf>

harmonizimit të ligjit me KPRK, janë aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.⁴

Sfidat:

Bazuar në përfundimet e procesit të DPSA-së, në seksionin 2: Lufta kundër korrupsionit, AKK-ja thirret që të bëjë kontrollin e pasurisë së deklaruar.

Pavarësisht faktit që numri i zyrtarëve të lartë publik që refuzojnë të bëjnë publike pasuritë e tyre ka rënë dukshëm gjatë dy viteve të fundit prapëseprapë, verifikimi i **a)** origjinës së pasurisë së deklaruar; dhe **b)** vërtetësisë së përmbajtjes së deklaruar (pasurisë), nuk mund të bëhet për shkak të mandatit të kufizuar ligjor të AKK-së, por edhe mungesës së mekanizmave në dispozicionin e saj.

Mandati i AKK-së, derivon nga Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit,⁵ neneve të Ligjit për Deklarim të Pasurisë, si dhe provizioneve të KPRK-së, Agjencia nuk ka të drejtë ligjore të nisë hetime përmbajtësore të origjinës së pasurisë, por as të ndërmarre verifikim të gjërë mbi vërtetësinë e informatave të ofruara në regjistrin për deklarim.

Për shembull, në një aspekt, neni 15, pika 2 dhe 3,⁶ të Ligjit për Deklarim të Pasurisë, obligon personat fizik dhe juridik dhe posaçërisht, obligon bankat dhe institucionet e tjera që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Kosovë, t'i ofrojnë të dhëna AKK-së në lidhje me depozitat, xhironlogaritë si dhe transaksionet e tjera për personat, që sipas Ligjit, janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë. Mirëpo, ky nen është në

⁴ Shih amendamentet në kuadër të nenit 17 të Ligjit për Deklarim të Pasurisë të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës me 20 mars 2014.

<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/04-L-228%20a.pdf>

⁵ Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>

⁶ Ligji për Deklarim të Pasurisë; Neni 16; Detyrimi për ofrimin e të dhënave:

1. Agjencia kërkon deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre si dhe mund të bëjë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve.
2. Gjatë kryerjes së kontrollit dhe verifikimit të të dhënave të deklarimit të pasurisë, Agjencia mund të kërkojë apo shfrytëzojë të dhënat nga të gjithë personat fizik dhe juridik, konform Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Me kërkesë të Agjencisë, Bankat dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Kosovë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim.
4. Subjektet e cekura në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, janë të detyruara të vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim nga Agjencia.

<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

konflikt direkt me nenin 84,⁷ si dhe nenin 91⁸ të KPP-së, gjë e cila e zhvlerëson të drejtën e AKK-së të kërkojë informata nga bankat dhe institucionet e tjera që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare.

Duke e pasur parasysh që AKK-ja, është e pafuqishme karshi kërkesave ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare për të kërkuar informata në lidhje me depozitat, xhirollogaritë apo edhe transaksionet e tjera, në mënyrë të theksuar e limitojnë kapacitetin e Agjencisë, për të verifikuar/kontrolluar pasuritë e deklaruar.

Posaçërisht, problemi i hetimit gjithëpërfshirës të pasurisë së deklaruar përkeqësohet kur është në pyetje hetimi i saj. Edhe pse Ligji për Deklarim të Pasurisë i ofron mandat AKK-së, të ndërmarrë kontrole për të verifikuar origjinën e pasurisë së deklaruar,⁹ si dhe regjistri i pasurisë përmbanë pjesë ku zyrtarët obligohen që të ofrojnë informacion për prejardhjen e pasurisë së tyre prapëseprapë, nuk ka asnjë të dhënë se Agjencia ka ndërmarrë ndonjë hetim përkitazi me origjinën e pasurisë së deklaruar.¹⁰ Në disa aspekte, AKK-ja, është ligjërisht e kufizuar, por edhe nuk posedon kapacitete institucionale për të ndërmarrë hetime gjithëpërfshirëse rreth origjinës së pasurisë së deklaruar.

Rekomandimet:

- Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse dhe e detajuar rreth mangësive dhe paqartësive të Ligjit për Deklarim të Pasurisë.
- Të amandamentohen KPRK, KPP, si dhe Ligji për Deklarim të Pasurisë për sa i përket mandatit të AKK-së, për të hetuar origjinën e pasurisë, dhe të zgjerohen kompetencat e AKK-së, përkitazi me verifikimin e saktësisë së informatave të ofruara në deklaratat e pasurisë.
- Të sqarohet **roli** dhe **mandati** i AKK-së, për sa i përket kompetencave në hetimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

⁷ Kodi i Procedurës Penale - KPP- MARRJA E INFORMATAVE; Neni 84; Masat e marra para fillimit të procedurës penale.

⁸ KPP - Neni 91; Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

⁹ Ligji për Deklarim të Pasurisë; Neni 16; Detyrimi për ofrimin e të dhënave:

1. Agjencia kërkon deklarinë e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre si dhe mund të bëjë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve.

¹⁰ Shih raportet vjetore të AKK-së. <http://www.akk-ks.org/?cid=1,16>

b) **Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të publik (nr. 04/I-051) (nga këtu, ligji për parandalimin e konfliktit të interesit)**

Gjendja:

Rregullimi i konfliktit të interesit për sa i përket ushtrimit të funksionit publik është aspekti më kompleks dhe më së paku i rregulluar në gjithë fushën kundër korrupsionit. Komisioni Evropian në konkluzionet e DPSA-së, të datës 28-30 janar 2014, kërkon nga Kuvendi i Kosovës, që të adoptojë amandamentet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në mënyrë që të harmonizohet me ndryshimet në Kodin Penal. Megjithatë, disa probleme që janë shfaqur gjatë implementimit të ligjit nuk janë adresuar as në Raportin e Progresit të vitit 2013, por as në konkluzionet e DPSA-së.

Që nga viti 2013, autoritetet e Kosovës kanë amandamentuar KPRK, i cili penalizon konfliktin e interesit,¹¹ një përparim i nevojshëm dhe shumë i duhur në legjislacionin anti-korrupsion. Megjithatë, paqartësitë dhe të metat e shumta janë ende prezente.

Sfidat:

Sfida e parë për sa i përket harmonizimit të Ligjit dhe KPRK-së, ka të bëjë me konsolidimin e Legjislaturës së re dhe mundësisë që ajo të aprovojë ndryshimet e bëra para periudhës raportuese për Raportin e Progresit.¹²

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, saktëson qartë në nenin 1 se: "Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit ndërmjet **interesit publik** dhe **interesit privat** të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksionit publik."¹³ Gjatë zbatimit të ligjit, AKK-ja ka sjellë një numër të madh të vendimeve rreth konfliktit të interesit, dhe atë, jo vetëm në ato raste nuk ka një ndarje të qartë të sferës publike me atë private, por edhe për ato raste kur konflikti i interesit është shfaqur vetëm brenda sferës publike.¹⁴ Shfaqja e konfliktit të interesit në ato raste kur sfera publike dhe ajo private ndeshen, është shumë më e drejtpërdrejtë dhe

¹¹ KPRK – Neni 424; Konflikti i Interesit.

¹² Ndryshimet e domosdoshme në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për sa i përket harmonizimit me KPRK janë bërë nga Legjislatura e kaluar.

¹³ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; Neni 1, Qëllimi.

¹⁴ Shih vendimet e AKK-së rreth konfliktit të interesit. <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1170>

më e lehtë për t'u zbuluar dhe parandaluar por, kjo ndarje, gjatë zbatimit të ligjit, është treguar shumë me e ndërlikuar dhe rrjedhimisht më vështirë për t'u parandaluar kur konflikti i interesit, shfaqet vetëm brenda sferës publike. Ligji nuk specifikon se kur një zyrtar mund të jetë në konflikt interesi, kur për shembull ushtron dy funksione publike në të njëjtën kohë, apo se në cilat situata konflikti i interesit mund të ndodhë kur ekskluzivisht, sfera publike është në pyetje.

Në kuadër të argumentit të lartpërmendur, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk i specifikon kategoritë në mes funksioneve publike dhe lidhjes së tyre me konfliktin e interesit. Ligji, për shembull, nuk saktëson se çka përbën konflikt të interesit për një deputet, një ministër, apo ndonjë zyrtarë tjetër të lartë i cili hynë në kuadër të ligjit. Në këto raste, AKK-ja mbetet me mundësinë e interpretimit të ligjit, para se të fokusohet vetëm në zbatimin e tij, dhe në këto raste me mundësinë e prurjes së vendimeve të ndryshme dhe kontradiktore për raste të njëjta.¹⁵

Edhe pse KPRK, përmban sanksione penale kur një person zyrtar merr pjesë personalisht në një çështje zyrtare në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes ka ndonjë interes financiar, prapëseprapë, Kodi nuk përmban sanksione në lidhje me: 'fshehjen e konfliktit të interesit'; 'refuzimin për të deklaruar konfliktin e interesit'; apo, 'deklarimi jo i drejtë i konfliktit të interesit'. Për më shumë, ka kategori të ndryshme dhe kontradiktore në KPRK si dhe në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për sa i përket klasifikimit të: 'anëtarëve të familjes', dhe 'person i afërt me zyrtarin'. Kodi Penal saktëson qartësisht që konflikti i interesit ndodhë kur: "Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë *anëtar i familjes* ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar", përderisa Ligji, parasheh konfliktin e interesit edhe kur përfshinë kategorinë "person i afërt me zyrtarin".¹⁶ Fusha e 'anëtar i

¹⁵Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!; "Vendime kontradiktore të AKK-së rreth konfliktit të interesit". <http://www.cohu.org/sq/Reagime-i/Vendime-kontradiktore-t-AKK-s-mbi-konfliktin-e-interesit-120>

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – QKGH; "AKK e zbaton ligjin sipas qejfit"; Besnik Boletini; October, 2012. <http://www.preportr.com/sq/Re-publika/AKK-e-zbaton-ligjin-sipas-qejfit-220>

¹⁶Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; Neni 3; Përkufizimet;

1.4. **Person i afërt me zyrtarin** – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adaptuesi, i adaptuari, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.

familjes,¹⁷ sipas KPRK është shumë më e ngushtë krahasuar me fushën e “person i afërt me zyrtarin”, që ofrohet në Ligj.

Neni 8, pika 1,¹⁸ kërkon nga zyrtari i lartë që personalisht të parandalojë dhe zgjidhë brenda suazave të Ligjit dhe në mënyrë efektive çdo situatë të konfliktit të interesit në të cilën ai/ajo mund të ndodhen. Por, as neni i lartë përmendur, por as Ligji nuk e saktësojnë kohën brenda së cilën zyrtari duhet të zgjidhë situatën e konfliktit të interesit. Për më shumë, Neni 8, pika 3, kërkojnë nga çdo udhëheqës dhe institucion të ndërmarr masa të nevojshme të parandalojë dhe zgjidhë situata të konfliktit të interesit.¹⁹ Prapë, Ligji nuk specifikon masat e nevojshme të cilat duhen të merren, apo edhe kohën brenda së cilës këto masa duhet të zbatohen. Neni 15 paragrafët 5 dhe 6,²⁰ ndalojnë zyrtarin e lartë që të lidhë kontrata apo përfitojë ndihmë nga institucionet qendrore apo lokale në të cilat, ai/ajo mbajnë pozitë vendim-marrëse, edhe në ato raste kur

¹⁷ KPRK - KAPITULLI XIII; DOMETHËNIA E SHPREHJEVE NË KODIN PENAL; Neni 120;

Përkufizimet:

23.Marrëdhënie familjare - marrëdhënie në mes të dy (2) personave:

23.1. që janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose që bashkëjetojnë me njëri tjetrin pa martesë;

23.2. që e kanë të përbashkët shtëpinë kryesore dhe që janë të afërm të gjakut, martesës, adoptimit ose janë në marrëdhënie të kujdestarit, duke përfshirë prindërit, gjyshin e gjyshen, fëmijët, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë; ose

23.3. që janë prindër të fëmijës së përbashkët.

33. Anëtar i familjes - prindi, prindi i adoptuar, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti

ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në

bashkësi jashtëmartesore.

¹⁸ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; Neni 8; Detyrimi i zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit:

1. Zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.

¹⁹ Po aty, Neni 8; Detyrimi i zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit:

3. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

²⁰ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; Neni 15; Mos pajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik:

5. Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitoj ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse.

6. Nëse zyrtari i lartë bie në kundërshtim me paragrafin 5. të këtij neni, atëherë Agjencia duhet të kërkojë nga organi kompetent anulimin e kontratës me ndërmarrjen apo kthimin e çfarëdo përfitimi material të ndërmarrjes nga Institucioni në të cilin zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse.

aksionet apo pjesë të pasurisë së tij janë duke u menaxhuar nga personi i besuar, dhe i jep të drejtë AKK-së që të kërkojë nga organi kompetent të anulojë kontratën me kompaninë dhe të kthej çdo të mirë materiale të përfituar nga institucioni ku zyrtari ka pasur pozitë vendim-marrëse. Por, çka ndodhë në situatën hipotetike, në rast se ndërmarrja e personit zyrtar e transferuar tek personi i besuar lidh kontratë me institucionet qendrore ose lokale në të cilin zyrtari është në pozitë vendimmarrëse, e kryen punën dhe e merr përfitimin material, ndërsa për këtë kontratë merret veshë shumë më vonë, p.sh. pas një viti kur edhe ka përfunduar kontrata, si mund të kthehet kjo në situatën e mëparshme?

Rekomandime:

- Të bëhet një analizë e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me fokus të veçantë në eliminimin e zbrazëtirave dhe paqartësive, si dhe në definimin e fushë veprimit të tij.
- Të sqarohen situatat kur konflikti i interesit mund të ndodhë brenda sektorit publik, por edhe në relacion me atë privat.
- Të kategorizohet/definohet konflikti i interesit karshi pozitave/funksioneve të zyrtarëve të lartë publik.
- Të merren masa për të penalizuar: 'refuzimin për të deklaruar konfliktin e interesit'; 'deklarimin fals të konfliktit të interesit' dhe; 'fshehjen e konfliktit të interesit'.

II. Seksioni 4.3. Drejtësia, liria dhe siguria;

4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit

Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale (nr. 04/I-140) (nga këtu: ligji për konfiskim të pasurisë)

Gjendja:

Komisioni Evropian në konkluzionet e 28-30 janarit të DPSA-së, kërkon nga disa institucione (PK, KP, KGJK dhe, MD) që të sigurojnë një qasje më proaktive në hetimin, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve. Për më shumë, konkluzionet kërkojnë nga gjyqësori që të përdorë mundësinë t'i ngrijë asetet gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore – shumë kohë para vendimit përfundimtar.²¹

Sipas neneve të KPRK-së, konfiskimi i aseteve mund të ndodhë vetëm në ato raste kur pasuria vjen si pasojë e shkaktimi të veprës penale. Në këto raste, gjyqet mund të sjellin vendim për konfiskim të pasurisë vetëm në ato raste kur ka një lidhje të qartë në mes veprës penale të shkaktuar dhe dobisë pasurore të përfituar.²²

Një përparim i vogël është bërë për sa i përket konfiskimit të pasurisë me vepër penale me aprovimin e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale. Sipas neneve të

²¹ KE – Konkluzionet e DPSA-së, pika 3.3, Konfiskimi i Aseteve.

²² KPRK - KAPITULLI VII; KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË FITUAR ME ANË TË KRYERJES SË VEPRAVE PENALE Neni 96; Baza e konfiskimit të dobisë pasurore:

1. Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale.

2. Dobia pasurore sipas paragrafit 1. të këtij neni konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e

veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj.

Neni 97; Kushtet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore

1. Kryesit i konfiskohet dobia pasurore apo kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.

2. Dobia pasurore mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale. Kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtari i familjes, përveç nëse anëtari familjar dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë.

Ligjit²³, e drejta për të nisur procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore nga prokurori i rastit lejohet, mirëpo duhet fillimisht që të ketë një

²³ KPRK - KAPITULLI II - KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT; Neni 6; Kushtet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal:

1. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga aktgjykimi i formës së prerë me të cilin i pandehuri shpallet fajtor për vepër penale nga Kapitujt XV, XXIII, XXIV, XXV ose XXXIV të Kodit Penal, dhe nëse Prokurori i shtetit mund, në një kërkesë tjetër paraqitur Gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, të ofrojë prova për të treguar shkak të bazuar se:
 - 1.1. i pandehuri ka fituar pasuri tjera që nuk kanë qenë dobi pasurore nga ato vepra penale, për të cilat i pandehuri është dënuar;
 - 1.2. pasuritë tjera janë marrë pas 31 dhjetorit 1999;
 - 1.3. të hyrat legjitime të të pandehurit kanë qenë të pamjaftueshme për të mundësuar blerjen e atyre pasurive tjera;
 - 1.4. i pandehuri ka qenë i përfshirë në sjellje të ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor; dhe
 - 1.5. sjellja nga nënparagrafi 1.4. i këtij paragrafi do të mundësonte blerjen e atyre pasurive tjera.
2. Nëse kërkesa nga Prokurori i shtetit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk vërteton shkakun e bazuar nga nënparagrafi 1.1., 1.2. ose 1.3. i paragrafit 1. të këtij neni, Gjykata nxjerr vendim të arsyetuar me të cilin e refuzon kërkesën. Në të kundërtën, Gjykata i dërgon të pandehurit kopjen e kërkesës.
3. I pandehuri ka të drejtë të ketë mbrojtës gjatë procedurës sipas këtij neni.
4. Personi i dënuar ka afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kopjes së kërkesës së Prokurorit të shtetit për të paraqitur prova që pasuria është blerë nga të ardhurat legjitime.
5. Për ndonjë pasuri të përvetësuar nga personi i dënuar para periudhës së kohës së veprës penale për të cilën ai është dënuar, personi i dënuar mund të paraqesë prova se shënimet kadastrale ose dokumentet tjera të cilat mund të dëshmojnë se pasuritë janë blerë me të ardhura të ligjshme nuk është në dispozicion apo nuk është e besueshme.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues mban shqyrtimin në të cilin:
 - 6.1. të pandehurit i lejohet që të shqyrtojë provat që mbështesin kërkesën e Prokurorit të shtetit nga paragrafi 1. i këtij neni;
 - 6.2. Prokurorit të shtetit i lejohet që të shqyrtojë provat e paraqitura nga i pandehuri sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni;
 - 6.3. Pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës bona fide i pasurisë, në pajtim me nenin 5. paragrafin 4. të këtij ligji.
7. Nëse Gjykata çmon se pasuria është fituar nga aktiviteti i ngjashëm me veprimet kriminale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor, Gjykata nxjerr aktgjykim të arsyetuar, në të cilin:
 - 7.1. përcakton se pasuria është fituar brenda periudhës së njëjtë kohore me veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor;
 - 7.2. përcakton se të ardhurat legjitime të të pandehurit kanë qenë të pamjaftueshme për të bërë blerjen e asaj pasurie;
 - 7.3. përcakton se i pandehuri ka qenë i përfshirë në sjellje të ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor;
 - 7.4. përcakton se sjelljet e tilla do të mundësonin blerjen e asaj pasurie;
 - 7.5. përcakton se i pandehuri kishte mundësi për të treguar se pasuritë janë fituar me anë të të ardhurave të ligjshme;

aktgjykim dënues për të dyshuarin. **Pasuria mund të konfiskohet edhe nëse nuk ka ndërlidhje me veprën që dënohet, mirëpo në rrethana të ngjashme ose kur nuk mund të justifikohet pasuria e poseduar.** Mirëpo, prokurori duhet të bëjnë një kërkesë të bazuar, përndryshe kërkesa hidhet poshtë nga trupi gjykues.²⁴ Për më shumë, retroaktiviteti²⁵ është përfshirë në këtë ligj, por po ashtu, është përfshirë edhe një nuancë e vendosjes së barrës së provës²⁶ tek i dyshuari.

Sfidat:

Edhe pse Ligji ka vendosur një vijë ndarëse në mes dobisë pasurore së përfutur dhe shkaktimit të veprës penale, në praktikë akoma nuk kemi ndonjë rast të konfiskimit të pasurisë, që nuk ndërlidhet me ndonjë vepër penale, por gjithmonë konfiskimi ndërlidhet me veprën penale për të cilën dënohet i dyshuari. Për më shumë, lidhja direkte në mes veprës penale të shkaktuar dhe konfiskimit të aseteve, e vendosë barrën e provës tek i dyshuari, duke e bërë të gjithë përpjekjen e konfiskimit të aseteve një detyrë shumë të vështirë.

Konkluzionet e DSPA-së kërkojnë ngrirjen e aseteve gjatë kohës kur është duke u zhvilluar procedura gjyqësore, para se të arrihet vendimi

7.6. përcakton se i pandehuri nuk ka provuar se pasuria është fituar nga të ardhurat legjitime;

7.7. përcakton se konfiskimi i pasurisë nuk do të shkaktonte padrejtësi;

7.8. përcakton llojin e pasurisë dhe vlerën monetare të saj;

7.9. urdhëron që pasuria apo të drejtat pronësore të kalojnë në pronësi të Republikës së Kosovës apo të palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme;

7.10. detyron palët tjera t'ia dorëzojnë pasurinë Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme, nëse nuk janë dorëzuar në pajtim me nënparagrafin

7.9. të këtij paragrafi, ose për të paguar vlerën monetare të pasurisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë; dhe

7.11. urdhëron që në regjistrat publik të Gjykatës apo organit tjetër të bëhen ndryshimet përkatëse të së drejtës pronësore në emër të Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme.

8. Kundër aktgjykimit nga paragrafi 7. i këtij neni lejohet ankesë.

²⁴ Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale neni 6.

²⁵ KPRK - KAPITULLI II - KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT; Neni 6; Kushtet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal:

1.2. pasuritë tjera janë marrë pas 31 dhjetorit 1999;

²⁶ Po aty,

4. Personi i dënuar ka afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kopjes së kërkesës së Prokurorit të shtetit për të paraqitur prova që pasuria është blerë nga të ardhurat legjitime.

përfundimtar. Mirëpo, baza e konfiskimit të aseteve është, KPRK, KPP, si dhe Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale, në të cilat, termi, 'ngrirje e aseteve', nuk përmendet, por ato i referohen vetëm institucionit të konfiskimit. Kjo nënkupton se infrastruktura ligjore e Kosovës nuk e njeh institucionin e ngrirjes, por vetëm të konfiskimit dhe atë vetëm pas një vendimi gjyqësor, përmes së cilit, i dyshuari gjendet fajtor për një vepër penale. Pas verdiktit përfundimtar për vepër penale, prokurori, mundet brenda 30 ditëve, të nisë një hetim për pasurinë e dyshimtë që personi i dënuar e posedon. Kjo nënkupton se asnjë hetim, ngrirje apo, konfiskim i aseteve nuk mund të ndodhë pa një vendim gjyqësor rreth një vepre penale.

Marrë parasysh që e gjithë infrastruktura ligjore në lidhje me konfiskimin e pasurisë është e bazuar në spektrin penal të legjislacionit, rekomandohet që përpjekjet për të konfiskuar pasuri të bien në domenin e spektrit civil. Në këtë kuptim, edhe barra e provës do të kalojë tek i dyshuari, si dhe të parandalohet parashkrimi i veprës.

Rekomandime:

- Hartimi i një ligji të ri për konfiskimin e pasurive të paligjshme/pashpjegueshme.
- Depenalizimi i konfiskimit të pasurisë – mundësia që të nisin hetimet, ngrirja dhe konfiskimi brenda domenit civil të legjislacionit pa pasur nevojë që të ketë lidhje me procedura penale dhe vepër penale.
- Barra e provës të bjerë tek i dyshuari.
- Përfshirja e instrumenteve të *ngrirjes*, *sequestrimit* dhe konfiskimit në ligjin e ri.
- Mbajtja e retroaktivitetit.

Fusha e hulumtimit	Kërkesat e BE-së përmes dokumenteve të ndryshme (Raporti i Fizibilitetit, Raporti i Progresit 2013, Konkluzionet e DPSA-së, dhe Udhërrëfyeti për Liberalizim të Vizave	Veprimet e ndërmarra nga institucionet vendore	Kërkesat dhe rekomandimet e Organizatës ÇOHU!
Deklarimi i pasurisë	• AKK-ja të merret me kontrollin e pasurisë së deklaruar²⁷, • Harmonizimi i ligjit me Kod Penal ²⁸	• Asgjë • Amandamentimet në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë rreth harmonizimit me KPRK janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, me 20 Mars 2014.	• Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse dhe e detajuar rreth mangësive dhe paqartësive të Ligjit për Deklarim të Pasurisë. • Të amandamentohen KPRK, KPP, si dhe Ligji për Deklarim të Pasurisë për sa i përket mandatit të AKK-së për të hetuar origjinën e pasurisë, dhe të zgjerohen kompetencat e AKK-së, përkritazi me verifikimin e saktësisë së informatave të ofruara në deklaratat e pasurisë. • Të sqarohet roli dhe mandati i AKK-së, për sa i përket kompetencave në hetimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

²⁷ EU- Kosovo Stabilization Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions Ref. Ares (2014)393846-18/02/2014

²⁸ Po aty.

Konflikti i interesit	- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit ka nevojë për obligime përkatës të raportimit, pasi aktualisht rastet e konfliktit të interesit vazhdojnë të jenë kryesisht jo të raportuar²⁹. - Duhet të amendamentohet ligji për parandalimin e konfliktit të interesit për t'u harmonizuar me Kod Penal³⁰	- Asgjë - Asgjë	- Të bëhet një analizë e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me fokus të veçantë në eliminimin e zbrazëtirave dhe paqartësive, si dhe në definimin e fushëveprimit të tij. - Të sqarohen situatat kur konflikti i interesit mund të ndodhë brenda sektorin publik, por edhe në relacion me atë privat. - Të kategorizohet/definohet konflikti i interesit karshi pozitive/funksioneve të zyrtarëve të lartë publik. - Të merren masa për të penalizuar: 'refuzimin për të deklaruar konfliktin e interesit'; 'deklarimin fals të konfliktit të interesit' dhe; 'fshehjen e konfliktit të interesit'.
Konfiskimi i pasurisë	Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për konfiskim, dhe realizimi i hetimeve proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë, të zhvillojë dhe të zbatojë një sistem solid për konfiskimin dhe menaxhimin e pasurisë³¹	- Baza ligjore për konfiskim të aseteve bazohet në: ➤ Kodin Penal të Kosovës ➤ Kodin e Procedurës	- Hartimi e një ligji të ri për konfiskimin e pasurive të paligjshme/pashpjegueshme. - Depenalizimi i konfiskimit të pasurisë – mundësia që të nisin hetimet, ngrirja dhe konfiskimi brenda domenit civil të legjislacionit pa pasur nevojë që të ketë lidhje me procedura penale dhe vepër

²⁹ Komunikata e Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për MSA mes BE dhe Kosovë 2012.

³⁰ EU- Kosovo Stabilization Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions Ref. Ares (2014)393846-18/02/2014

³¹ Udhrrëfytyrë për Liberalizimin e Vizave për Kosovën

	• Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë duhet të sigurojnë qasje më proaktive sa i përket hetimit, ngrirjes dhe konfiskimit të pasurisë³² • Gjyqësori duhet të krijojë mundësinë e ngrirjes së pasurisë derisa është duke u zhvilluar procedura gjyqësore, para se të nxirret verdikti gjyqësor³³	Penale ➤ Ligjin për Zgjerimin e Kompetencave të konfiskimit të Pasurisë me Vepër Penale • Konfiskimi i aseteve është i ndërlidhur me shkaktimin dhe dënimin e veprës penale. • Në këtë kuptim, baza ligjore nuk e parasheh institucionin juridik të ngrirjes së pasurisë. • Kështu asgjë nuk është bërë në aspektin e ngrirjes së pasurisë,	penale. • Barra e provës të bjer tek i dyshuari. • Përfshirja e instrumenteve të <i>ngrirjes, sekuestrimit</i> dhe konfiskimit në ligjin e ri. • Mbajtja e retroaktivitetit.
--	--	---	---

³² EU- Kosovo Stabilization Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions Ref. Ares (2014)393846-18/02/2014

³³ EU- Kosovo Stabilization Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions Ref. Ares (2014)393846-18/02/2014